



Të nderuar lexues të RSK-së,

Me publikimin e numrit të parë të Revistës së Stomatologëve të Kosovës, filloi një epokë e re e afirmimit të profesionit të stomatologut në Kosovë e më gjerë. Përmes shkrimeve të botuara në revistën tonë është konsoliduar edhe një mision fisnik i Odës së Stomatologëve të Kosovës për të qenë në hap me organizatat dhe shoqatat simotra në rajon dhe në botë. Lexuesit e numrit të dytë të RSK do të kenë rastin të njihen me disa nga hulumtimet dhe vështrimet e fundit nga fusha të ndryshme të stomatologjisë. Përveç autorëve kontribuues nga Kosova, në këtë numër kemi rastin të njihemi me punën dhe aktivitetin profesional e shkencor të kolegëve nga Kroacia, Gjermania, Shqipëria dhe Turqia.

Kështu, temat e zgjedhura për këtë numër shtjellojnë, mes tjerash, X-efektin në trajtimin ortodontik, diagnozën dhe trajtimin e alveolitit, vetitë obturuese të pastave gjatë trajtimit endodontik, sistemin e printimit tredimensional në implantologji, stresin e vidave ortodontike nga materiale të ndryshme, laserin Er:YAG në endodonci, trajtimin jo-kirurgjik parodontal, faktorët e traumave dentare, protezat parciale termoplastike, analizën e cilindrave të kafshimit në artikulatort, etj. Pjesë të këtij numri do të jenë edhe portreti i doajenit të stomatologjisë kosovare, Prof. Dr. Rifat Ymerit, vështrimi i botimeve të reja nga stomatologjia, si dhe kalendari i ngjarjeve më të rëndësishme nga stomatologjia që do të mbahen gjatë vitit 2023. Dhe në fund, por jo edhe me më pak rëndësi, dëshiroj të shpreh falënderimin e veçantë për Agjencinë e Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut - Lux-Dev, që ka përkrahur aktivitetet e Redaksisë së RSK-së për botimin e suksesshëm të këtij numri.

Lexusve të RSK-së ju urojmë festat e fundvitit dhe Vitin e Ri 2023!

Lexim të këndshëm!

Dr. Sci. Kastriot Meqa,  
Kryeredaktor i RSK-së